



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E AUDITIT TË BRENDSHËM**

Nr. 673 prot.

Elbasan, më 09. 02.2026

**MIRATOHET
KRYETARI**

z.Gledian LLATJA

Lënda: Rregullore e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm / Bashkia Elbasan

“Për organizimin, funksionimin, punësimin, detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm”.

Misioni:

Auditi i Brendshëm është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive, të arsyeshme dhe i ofron këshillim Kryetarit të Bashkisë. E projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë dhe arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike.

Misioni i njësisë së auditimit të brendshëm, si pjesë e strukturës Bashkisë Elbasan është orientimi i veprimtarisë, në mënyrë të pavarur dhe profesionale, duke dhënë siguri objektive, për përdorimin me efikasitet, efektivitet & ekonomi, menaxhimin e burimeve, përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e riskut, ndjekjen e praktikave më të mira bashkëkohore dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të auditimit.



Objektivat:

Vlerësimi i përmbushjes së objektivave të veprimtarisë në Bashkinë Elbasan dhe institucionet e vartësisë.

Vlerësimi i efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm, transaksioneve, si dhe besueshmërinë e sistemeve.

Dhënia dhe ndjekja e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së AB-së dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm, kontabilitetit përputhje me standartet profesionale.




Baza Ligjore:

Veprimtaria e drejtorisë së auditit brendshëm bazohet në:

- Ligjin nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” , *(i ndryshuar)* me ligjin nr.12/2023 datë 02.02.2023.
- Manualin e miratuar me Urdhërin nr.134 datë 17.10.2025, të Ministrit të Financave.
- V.K.M-në nr.83 datë 03.02.2016 “Për Miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë së auditit të brendshëm në sektorin publik”.
- Urdhër nr.86 datë 10.12.2015 “Miratimin e kodit të etikës për audituesve të brendshëm në sektorin publik”.
- Urdhër nr.103 datë 23.07.2025 “ Për Miratimin e Standarteve Globale të Auditimit të Brendshëm të Pranuara për Zbatim në Sektorin Publik në Republikën e Shqipërisë”.
- “Karta e auditimit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm”,e miratuar me nr. prot datë __. __.2026 nga Kryetari i Bashkisë Elbasan.
- “Programi për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë” i miratuar me nr. prot datë __. __.2026 nga Kryetari i Bashkisë Elbasan.

🌟 Organizimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm.

Struktura dhe organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm, miratohet me urdhër të Kryetarit, si pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Elbasan. Niveli i pagës sipas pozicioneve të punës miratohet me Vendim të Këshillit Bashkiak, brenda kufijve të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Kjo njësi ka varësi organizative nga Kryetari i Bashkisë dhe aktualisht është e miratuar me një drejtues (*kategoria II-2*) dhe katër specialistë (*kategoria IV-2*).



🌟 Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

Në kuadrin e zbatimit të praktikave profesionale duhet te realizojë sipas formateve standarte :



- a) hartimin e planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planet e miratuara;
- b) vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve dhe kontrolleve të brendshme, duke u fokusuar kryesisht në identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;
- c) përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin ligjor;
- d) ruajtjen e aseteve të njësisë publike, besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional të njësisë publike;

- e) dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike;
- f) ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna;
- g) informimin e titullarit të bashkisë ;

❖ **Detyrat e Drejtuesit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm .**

Drejtuesi i njësisë së auditit të brendshëm është nëpunës civil, ka vartësi direkte nga Kryetari i Bashkisë dhe ka detyrat si më poshtë:

- a) hartimin e “Kartës së Auditimit”, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me nenin 8 të ligjit “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik ” si dhe akte të tjera specifike për kryerjen e shërbimit të auditimit;
- b) hartimin e programit të sigurimit të brendshëm të cilësisë;
- c) hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e auditit të brendshëm dhe dërgimin për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditit të brendshëm, pas miratimit nga titullari i njësisë publike;
- d) organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së auditimit;
- e) kontrollon cilësinë e angazhimeve të auditimit;
- f) përgatitjen e raportit vjetor, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm;

➤ **Përgjegjësitë e Drejtuesit të Njësisë së Auditit të Brendshëm.**

- a) organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin;
- b) zbatimin e planit strategjik e vjetor të miratuar;
- c) vlerësimin periodik dhe të performancës mbi aktivitetin vjetor të kësaj drejtorie sipas programit të sigurimit të brendshëm të cilësisë;
- d) vlerësimin periodik të nëpunësve në zbatim të VKM-së nr.109 datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil", i ndryshuar;
- e) raportimin menjëherë në formë të shkruar tek titullari i njësisë publike dhe tek Ministri i Financave, i cili ka në varësi strukturën e inspektimit financiar publik, kur zbulon parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e njësisë së auditimit përbëjnë vepër penale ;
- f) të respektojë kërkesat metodologjike të manualit lidhur me afatet kohore *(nga njoftimi për fillim angazhimit deri në përgatitjen e raportit përfundimtar)*;
- g) në çdo rast të ndryshimeve të planit vjetor të auditimit, bën rishikimi e tij dhe pas arsyetimit dhe argumentimit me shkrim të ndryshimeve të bëra, merr miratimin nga Kryetari i Bashkisë, dhe e përcjell këtë plan të rishikuar pranë Njësisë Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm;

❖ **Detyrat e Specialistëve (audituesve të brendshëm).**

Audituesit e brendshëm janë nëpunës civil, në vartësi të drejtuesit të njësisë auditimit dhe kanë këto detyra:

- a) të njohin, të respektojnë dhe të ushtrojnë veprimtarinë audituese në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me standardet ndërkombëtare, të pranuar, të auditimit të brendshëm;
- b) të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive dhe me profesionalizëm;
- c) të veprojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës, Kartën e Auditimit dhe rregullat për konfidencialitetin për audituesin e brendshëm;
- d) të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit;
- e) të ruaj konfidencialitetin e të dhënave, fakteve apo rasteve të gjetura gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajnë dokumentet për çdo angazhim auditimi të kryer, bazuar në detyrimet, që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar;
- f) të përditësojnë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që t'i përdorin ato me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit;
- g) të japin rekomandime për njësinë e audituar për përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare për zhdëmtimin e tyre dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes;
- h) ushtron veprimtarinë audituese dhe mbikëqyrëse në përputhje me planin vjetor të miratuar, me përjashtim të rasteve kur janë miratuar ndryshime të paparashikuara nga titullari;
- i) të raportojë menjëherë te drejtuesi i njësisë së auditit kur zbulohen parregullsi apo veprime, që në vlerësimin e audituesve të brendshëm përbëjnë vepër penale;


❖ **Përgjegjësitë e Specialistëve (audituesve të brendshëm) janë:**

- a) Të hartojnë programin e angazhimit të auditimit të njësisë apo veprimtarisë publike të ngarkuar për auditim, duke zbatuar manualin e auditit dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, për pjesët që rregullojnë procedurat e kësaj faze të auditimit.
- b) Të zhvillojnë auditimin bazuar në metodologjinë e parashikuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik.
- c) Audituesi i brendshëm, merr pjesë në të gjitha fazat e ciklit të auditimit që nga;
 - hartimi i Planit të Auditimit, - punës në terren dhe ndërtimin e evidencës së auditimit, raportimin e rezultateve të auditimit dhe përgatitjen dhe dorëzimin e dosjes pjesore të auditimit që përmban veprimtarinë e tij audituese, si pjesë e dosjes së auditimit të njësisë publike;
- d) Të kryejnë procesin e rishikimit të brendshëm të cilësisë në rastin kur caktohet nga drejtori i drejtorisë për të kryer këtë detyrë, duke zbatuar Manualin e Udhërrefyesin si dhe të dokumentojë këtë proces sipas formateve standart të dokumentave më sipër.
- e) Të përgatitin dokumentacionin me formate standart të përcaktuar në manualin e auditimit të brendshëm dhe në standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të AB.
- f) Përgatitja e materialeve; projekt-raportit, raportit-përfundimtar sipas afatit të përcaktuar në manualin e auditimit.
- g) Të respektojnë kërkesat metodologjike të manualit lidhur me afatet kohore.

- gj) Zbatimin e Programit të sigurimit të brendshëm të sigurimit të cilësisë (*sipas anekseve 1 & 2 të miratuara*).
- h) Të ndjekë trajnimin e vijueshëm profesional (*çdo vit*) pranë NJH/AB.

✿ Kufizimet në veprimtarinë e audituesve të brendshëm Audituesve të brendshëm u ndalohe:

Audituesve (*specialistëve*) të brendshëm u ndalohe të;



- a) të përfshihen në kryerjen e funksioneve dhe veprimtarive të tjera të njësisë publike, përveç veprimtarisë audituese;
- b) të mbajnë një mandat politik apo të jenë zgjedhur në funksione drejtuese në strukturat e partive politike;
- c) të ushtrojnë çdo veprimtari ose punë tjetër me pagesë apo të kenë përfitime të tjera të natyrave dhe formave, që krijojnë gjendje konflikti interesash me ushtrimin e auditimit, me përjashtim të mësimdhënies dhe publikimit, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil;

✿ Punësimi i audituesve të brendshëm



Njësia e auditit të brendshëm përbëhet nga auditues të brendshëm, që punësohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil.

Përveç kushteve të përgjithshme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit që punësohen në njësinë e auditimit të brendshëm, kërkohet plotësimi i kushteve të posaçme si më poshtë:

- a) të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet;
- b) drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të jetë i çertifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik ” dhe të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion, nga të cilat jo më pak se 3 vjet në fushën e auditimit;
- c) audituesi i brendshëm duhet të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik ” dhe të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet në profesion;
- ç) nëpunësi civil ose punonjësi që punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe që nuk zotëron çertifikatën si “Auditues i brendshëm”, gjatë 3 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e drejtuesit të njësisë së Auditimit të Brendshëm ose të një audituesi të brendshëm të certifikuar dhe me eksperiencë. Brenda kësaj periudhe, ky punonjës i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”. Në rast se brenda këtij afati nëpunësi civil ose punonjësi nuk certifikohet si “Auditues i brendshëm në sektorin publik ”, i ndërpriten marrëdhëniet e punës, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak të këtij ligji;

♣ Njohja me rregulloren



Të gjithë nënpunësit e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Elbasan, duhet të njihen individualisht me këtë rregullore.

♣ Sanksione

- Mos-respektimi i rregullores së Auditit të Brendshëm , përbën shkak për procedim disiplinor për çdo specialist të auditit që shkel rregulloren, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (*kur nuk përbën vepër penale*).
- Mos-njohja e rregullores, nuk e justifikon shmangien e audituesve nga detyrat dhe përgjegjësitë.

Konceptoi:

Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm

Qemal TUSHA